

Pyetësor

1. Një forcë që ushtrohet mbi një trup:
 - Mund të bëjë ndryshimin e formës
 - Mund ta zhdukë atë
 - Nuk ka asnjë efekt mbi të
 - Nuk e lejon trupin të lëvizë
2. Nëse një forcë ushtrohet në një trup elastik duke e tendosur atë, çfarë energjie depozitohet te trupi?
 - Energjia e baticave
 - Energji kimike
 - Energji potenciale gravitacionale
 - Energji potenciale elastike
3. Cila është formula e saktë, që tregon lidhjen midis forcës elastike dhe shformimit?
 - $F = x$
 - $F = 2k \cdot x$
 - $F = k \cdot 2x$
 - $F = k \cdot x$
4. Cili nga objektet e mëposhtme mund të depozitojë më shumë energji potenciale elastike?
 - Një kapëse fletësh
 - Një laps
 - Një gomë
 - Një USB
5. Si lidhet shformimi i një trupi elastik me forcën elastike?
 - Janë në përpjesëtim të drejtë
 - Janë në përpjesëtim të zhdrejtë
 - Varet nga materiali që përbën trupin
 - Nga asnjëra nga të mësipërmet
6. Çfarë përfaqëson k në formulën e ushtrimit 5?
 - Forcën elastike që ushtrohet mbi trup
 - Shformimin e trupit
 - Konstanten e elasticitetit të sustës
 - Konstanten e shformimit

7. Nëse një trup elastik ka një konstante elasticiteti prej 10N/m dhe shformohet me 1m, sa është forca e ushtruar mbi të?
- 5 N
 - 10 N
 - 20 N
 - 60 N
8. Sa është shformimi i një suste me koeficient elasticiteti 30 N/ m ku mbi të ushtrohet një forcë prej 15 N?
- 0,5 m
 - 1 m
 - 2 m
 - 10 m
9. Një llastik tendoset nga një gjatësi fillestare 15 cm në një gjatësi 2 m. Nëse njëra anë e llastikut është e fiksuar dhe në anën tjetër është ushtruar forca 10 N, sa është koeficienti i elasticitetit të llastikut?
- 5,3 N/m
 - 5,4 N/m
 - 18 N/m
 - 20 N/m
10. Një sustë tendoset përtej një pike dhe, kur lëshohet, ajo nuk rikthehet në gjendjen e saj fillestare. Si quhet kjo pikë?
- Kufiri i këputjes
 - Kufiri i elasticitetit
 - Kufiri i përdredhjes
 - Kufiri i Borit

Pyetjet	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigjet e saktë	1	4	4	1	1	3	2	1	2	2